



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 877/3 Prot.

Durrës, më 13.03.2025

V E N D I M

Nr. 18, Datë 13.03.2025

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR.73, DATË 27.11.2024 " PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË PROGRAMIT TË RIORGANIZUAR MBI MASËN 20% NË CIKLIN E PARË "BACHELOR" NË "TEKNOLOGJI INFORMACIONI", PRANË DEPARTAMENTIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, NË FAKULTETIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 2, gërma b; neni 35 pika 1; neni 49; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar udhezimi i MAS nr.2, datë 21.01.2025; në Statutin e UAMD-së; Rregulloren e UAMD-së, vendimit të Senatit Akademik nr. 30, datë 11.03.2025, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I :

1. Në vendimin e Bordit të Administrimit nr. 73 , datë 27.11.2024, bazuar në pikën 3 kreu IV/A, të Udhëzimit të MAS Nr. 2, datë 21.01.2025, bëhen cilësimet si më poshtë:
 - c) Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën shqipe;
 - d) Kodi i programit të studimit: **S63BA0610**.
2. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2025-2026.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALI

